

VENDIM
Nr.323, datë 12.5.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË MUZEUT TË KONFERENCËS SË PEZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të pronës së paluajtshme shtetërore “Muzeu i Konferencës së Pezës”, me numër rendor 275, në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e parë+pjesa e dytë) të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”.

2.Prona e paluajtshme shtetërore “Muzeu i Konferencës së Pezës” të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha